

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për një ndryshim në ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, të ndryshuar’
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Konsultim
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Jo e zbatueshme
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	04/11/2021
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	PO,08.11.2021
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2021
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Eralda.shtylla@financa.gov.al ; eges.osmani@financa.gov.al ;
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?</i>	
<p>Problemi në shqyrtim është vlera e ulët e gjobave të parashikuara aktualisht në ligjin 9723/2007, “Për regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar.</p> <p>Ligji aktual në fuqi parashikon gjoba, në rast të mospërbushjes brenda afateve ligjor të detyrimit ligjor për kryerjen e regjistrimeve përkatëse në regjistrin tregtar dhe mosdeklarimeve reale, të cilat nga ana e International Co-operation Review Group (ICRG)’s Financial Action Task Force (ICRG/FATF) janë konsideruar të ulta dhe nuk pasqyrojnë Produktin e brendshëm bruto (GDP ose PBB) dhe Paritetin e Fuqisë Blerëse (PPP) të Republikës së Shqipërisë, pasi në vitin 2007 PBB/frymë është në vlerën 3385 usd ndërsa në 2020 është 5200 usd.</p> <p>Për këtë arsye, për të përmbushur rekomandimin e ICRG/FATF është e nevojshme bërja e ndryshimeve ligjore në Ligjin Nr. 9723, datë 03/05/2007, “Për regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, me qëllim parashikimin e vlerave më të larta të gjobave të zbatuara në rast të mospërbushjes brenda afateve ligjor të detyrimit ligjor për kryerjen e regjistrimeve përkatëse në regjistrin tregtar.</p> <p>Ndërhyrja e qeverisë nëpërmjet një politike të caktuar është e nevojshme, pikërisht për transparencën e të dhënave në Regjistrin Tregtar.</p>	
OBJEKTIVAT <i>Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?</i>	

Objektivat e këtij projektligji janë:

- 1) Forcimi i detyrimit për deklarimin e të dhënave të vërteta në Regjistër nga ana e subjekteve tregtare.
- 2) Forcimi i detyrimit për kryerjen e regjistrimeve të detyrueshme nga këta subjekte brenda afateve të parashikuara nga Ligji Nr.9723/2007.
- 3) Rritja e konkurrueshmërisë dhe përmirësimi i klimës së biznesit nëpërmjet deklarimeve reale dhe regjistrimit në kohë të bizneseve.
- 4) Të rritet më tej transparenca lidhur me deklarimet që bëjnë bizneset lidhur me të dhënat e tyre.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

Opsioni 0: – status quo-ja, të vijohet me kuadrin ligjor ekzistues

Opsioni 1: – Shfuqizimi i ligjit aktual dhe hartimi i një ligji të ri

Opsioni 2:- Ndryshimi i ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, me anë të së cilit synohet të rritet vlera e gjobave për regjistrimin e të dhënave të pavërteta nga subjektet tregtare dhe moskryerjen e regjistrimit fillestar brenda afateve të percaktuara dhe regjistrime të tjera të detyrueshme të subjekteve tregtare

Opsioni 3 (jorregullator) -Kryerja e fushatave sensibilizuese për zbatimin e rregullt të ligjit në fuqi; hartimi dhe publikimi i manualeve për rregullat procedurale që duhen ndjekur në kuadër të këtij ligji; rritja e kontrollit, nga strukturat pergjegjese, mbi strukturat dhe/ose bizneset/individët që duhet të zbatojnë legjislacionin në fuqi.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndikimet e drejtpërdrejta të opsionit të preferuar (Opsioni 2) janë;

- Rritja e ndërgjegjësimit të subjekteve për deklarimin e të dhënave reale;

Disa ndikime jo të drejtpërdrejta janë:

- Ulja e numrit të gjobave të vendosura si pasojë e rritjes së vlerës së tyre dhe ndërgjegjësimit të subjekteve;
- Sigurimi i një informacioni të vërtetë dhe të sigurt nga publiku, duke qenë se të dhënat e subjekteve publikohen në web-in e QKB në mënyrë transparente.
- Rritja e konkurrueshmërisë duke përmirësuar klimën e biznesit nëpërmjet respektimit të legjislacionit dhe deklarimin e të dhënave reale.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë bëri një analizë lidhur me aplikimin e gjobave për të njëjtën problematike nga vendet e rajonit dhe u pa se ato aplikojnë gjoba më të larta së Shqipëria për të njëjtat shkelje, konkretisht;

-Greqia aplikon gjobat në vlerat 600 euro-3000 euro për shkeljet e bëra në Regjistrin Tregtar;

- Mali i Zi aplikon gjobën prej 1000 euro;
- Sllovenia aplikon gjobën nga 200 euro-400 euro etj

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Referuar të dhënave në pikën më lart, gjoba e aplikuar në shtetin e Malit të Zi (1000 Euro), në Shqipëri do konvertohej në një vlerë rreth 670 Euro.

Nëse një përlllogaritje të tillë do të bëhej për vlerën e gjobës që aplikon shteti Slloven (400 Euro) do na rezultonte që këtu në Shqipëri kjo gjobë do të konvertohej në një vlerë rreth 140 Euro.

Nëse përsëri të njëjtën përlllogaritje të tillë do ta bënim referuar vlerës minimale të gjobës që aplikon shteti Grek (600 Euro) do të rezultonte që këtu në Shqipëri kjo gjobë do të konvertohej në një vlerë rreth 290 Euro.

Sikundër shihet përlllogaritjet e mësipërme japin vlera të ndryshme dhe më të larta se vlerat e gjobave të aplikuara në Shqipëri (15,000 lekë).

Nëse do të bënim një mesatare të këtyre vlerave të cilat aplikohen në rajon do të rezultonte një vlerë rreth 370 Euro.

Për këtë arsye mendojmë se vlera më e përshtatshme e propozuar për këtë gjobë të variojë midis shifrave 30,000 lekë deri në 45,000 lekë, gjë e cila përafrohet me dyfishimin ose trefishimin e vlerës së gjobës aktuale.

Opsioni i preferuar është Opsioni 2: – ndryshimi i ligjit ekzistues, i cili mundëson:

- a. rritjen e vlerës së gjobës në rast të:
 - a. deklarimit në regjistër i të dhënave të pavërteta, kur nuk përbën vepër penale,
 - b. Moskryerjes së detyrimit për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të detyrueshme, brenda afateve të parashikuara nga ligji nr. 9723/2007.
- b. përmbushjen e rekomandimeve të ICRG/FATF

Për sa më lart ky opsion arrin të plotësojë objektivat;

-Forcimi i detyrimit për deklarimin e të dhënave të vërteta në Regjistër nga ana e subjekteve tregtare.

- Forcimi i detyrimit për kryerjen e regjistrimeve të detyrueshme nga këta subjekte brenda afateve të parashikuara nga Ligji Nr.9723/2007.

- Rritjen e konkurrueshmërisë dhe përmirësimin e klimës së biznesit nëpërmjet deklarimeve reale dhe regjistrimit në kohë të bizneseve

-Të rritet më tej transparenca lidhur me deklarimet që bëjnë bizneset lidhur me të dhënat e tyre.

Referuar të dhënave nga QKB lidhur me numrin e bizneseve që nuk kryejnë detyrimin ligjor për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të detyrueshme, brenda afateve të parashikuara nga Ligji Nr. 9723/2007, vërejmë një ulje të numrit të gjobave nga 439 gjoba të vendosura në vitin 2019 në 297 gjoba të vendosura në vitin 2021. Nëpërmjet këtij opsioni synojmë të reduktojmë akoma edhe me shume numrin e bizneseve që kryejnë kundravajtjet administrative të përmendura më lart.

Kostoja e përlllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 2019

Viti 2020

Viti 2021

nuk aplikohet	nuk aplikohet	Nuk aplikohet	
KONSULTIMI			
<i>Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)</i>			
Projektligji do të hidhet në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimi Publik, si dhe konsultimi publik do të bëhet me përfaqësues të biznesit dhe njësitë e qeverisjes qendrore dhe vetqeverisjes vendore.			
ZBATIMI DHE MONITORIMI			
<i>Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?</i>			
Ligji do të zbatohet drejtpërdrejt nga subjektet tregtare që regjistrohen në regjistrin tregtar dhe Qendra Kombëtare e Biznesit. Ministria përgjegjëse për financat dhe ekonominë do të monitorojë zbatimin e opsionit të preferuar.			

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- Jepni kontekstin e politikës.

Ky ligj rregullon organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë e Qendrës Kombëtare të Biznesit, administrimin e regjistrit tregtar, përcakton subjektet që regjistrohen dhe procedurat e regjistrimit. Ligji 9723/2007, i ndryshuar, është amenduar here pas here në disa nene të tij pasi dihet që biznesi dhe procedurat që lidhen me të janë dinamike dhe këto amendime kanë qenë pikerisht në funksion të këtyre ndryshimeve (**ndryshuar me Ligjin nr.9916, datë 12.05.2008, Ligjin Nr.92/2012 dhe Ligjin Nr.8/2015**). Ky ligj është amenduar edhe me ligjin 39/2019, Në nenin 74, pas pikës 3 shtohen pikat 3/1 dhe 3/2 me këtë përmbajtje:

“3/1. Mosrespektimi i detyrimit të përcaktuar në pikën 4/1, të nenin 22, të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në masën 50 000 lekë.
3/2. Mosrespektimi i detyrimit të përcaktuar në pikën 4, të nenit 43, të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në masën 100 000 lekë.”.

Aktualisht Ligji Nr. 9723/2007 “Për regjistrimin e biznesit”, të ndryshuar, parashikon se:

- a. Deklarimi në regjistër i të dhënave të pavërteta, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 15 000 lekë.

- b. Moskryerja e detyrimit për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të detyrueshme, brenda afateve të parashikuara nga ky ligj, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 15 000 lekë.

Pra vlerat e gjobave aktuale (pika a) dhe b) janë shumë të ulta se ato të pikës 3/1 dhe 3/2.

Vlera e këtyre gjobave është përcaktuar në vitin 2007, kur është miratuar fillimisht Ligji Nr. 9723/2007 “Për regjistrimin e biznesit”, të ndryshuar dhe nuk kanë ndryshuar gjatë periudhës 2007 –2021, ndërkohë që dinamika e biznesit ka ndryshuar dhe koha ka treguar se përmbushja e detyrimeve ligjore është një domosdoshmeri për një funksionim normal të biznesit. Për të rritur forcimin e deklaramit për të dhënat reale dhe regjistrimet në afatin e caktuar është parë si mundësi më e mirë rritja e vlerës së gjobave për këto 2 pika.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria/biznesi /shoqëria civile /qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Problemi në shqyrtim është vlera e ulët e gjobave të parashikuara aktualisht në ligjin 9723/2007, “Për regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar për mosdeklarimin në regjistër të të dhënave të vërteta dhe moskryerja e regjistrimeve të detyrueshme, brenda afateve. Ky mospasqyrim ndikon në shtrirjen e problemit.

Grupet e prekura nga ky problem janë;

-Qytetarët, - të cilët marrin një informacion të pavërtetë duke qënë se në regjistër janë regjistruar të dhëna të pavërteta.

- Bizneset e tjera,- duke u cënuar konkurrueshmëria, si ne rastin e deklaramit të të dhënave të pavërteta ashtu edhe në rastin e moskryerjes së regjistrimit fillestar.

-Qeveria- me moskryerjen e regjistrimit fillestar, bizneset shmangin pagesën e detyrimeve tatimore dhe detyrimeve të tjera për aq kohë sa figurojnë të pa regjistruar në QKB dhe DPT.

Për këtë arsye, ICRG/FATF, në mënyrë të vazhdueshme ka rekomanduar rritjen e vlerës së gjobës, të cilat pasqyrojnë GDP dhe PPP e Republikës së Shqipëris, në rast të :

- a. deklaramit në regjistër i të dhënave të pavërteta, kur nuk përbën vepër penale,
- b. Moskryerjës së detyrimit për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të detyrueshme, brenda afateve të parashikuara nga ligji nr. 9723/2007.

Ky problem trajtohet me anë të përzgjedhjes së Opsionit 2:- Ndryshimi i ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, me anë të së cilit synohet të rritet vlera e gjobave për regjistrimin e të dhënave të

pavërteta nga subjektet tregtare dhe moskryerjen e regjistrimit fillestar brenda afateve të përcaktuara dhe regjistrime të tjera të detyrueshme të subjekteve tregtare

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Qeveria planifikon të ndërhyjë në Ligjin aktual 9723/2007 i ndryshuar, se në Raportin e FATF/ICRG jepet rekomandimi për rritjen e vlerës së gjobave, rekomandim të cilin në bazë të analizave krahasimore të dhëna edhe me sipër e konsiderojmë të drejtë dhe që duhet zbatuar sa më shpejt. Ky Raport është në funksion të vlerësimit të Shqipërisë nga Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Europës lidhur me çështjet e parandalimit të pastrimit të parave, financimit të territorizmit, përshtatshmërisë ligjore, efektivitetit etj, çështje prioritare për vendin tonë.

Ndërhyrja është e nevojshme për forcimin e detyrimit për regjistrimin fillestar dhe regjistrimeve të tjera në afatin e caktuar dhe deklarimin e të dhënave reale për të rritur transparencën me qytetarët, qeverinë dhe komunitetin e biznesit.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivat e këtij projektligji që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij janë;

1. Forcimi i detyrimit për deklarimin e të dhënave të vërteta në Regjistër nga ana e subjekteve tregtare.
2. Forcimi i detyrimit për kryerjen e regjistrimeve të detyrueshme nga këta subjekte brenda afateve të parashikuara nga Ligji Nr.9723/2007.
3. Rritjen e konkurrueshmërisë dhe përmirësimin e klimës së biznesit nëpërmjet deklarimeve reale dhe regjistrimit në kohë të bizneseve.
4. Të rritet më tej transparenca lidhur me deklaratimet që bëjnë bizneset lidhur me të dhënat e tyre.

Me vendosjen e Objektivave si më lart, permbushen rekomandimet e ICRG/FATF dhënë në Raportin për Shqipërinë në kuadër të MONEYVAL.

Objektivat e dhënë më lart janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura*

Gjatë vendimmarrjes lidhur me hapat ligjor që duhet të ndiqeshin për përmbushjen e rekomandimeve të ICRG/FATF janë vlerësuar opsionet e mëposhtme:

Opsioni 0: – status quo-ja, të vijohet me kuadrin ligjor ekzistues

Ky opsion nuk është i përshtatshëm për arritjen e objektivit, për arsye se kuadri ligjor ekzistues nuk realizon forcimin e detyrimit për deklarimin e të dhënave të vërteta në regjistër nga ana e subjekteve tregtarë, si dhe të detyrimit për kryerjen e regjistrimeve të detyrueshme nga këta subjekte.

Opsioni 1: – Shfuqizimi i ligjit aktual dhe hartimi i një ligji të ri.

Ky opsion nuk është i përshtatshëm, pasi rritja e gjobave të parashikuara në pikat 1 dhe 2, të nenit 74 të Ligjit Nr. 9723/2007 arrihet me anë të ndryshimit të Ligjit Nr. 9723/2007 dhe nuk shihet si i nevojshëm shfuqizimi i Ligjit aktual, pasi përveç pikave të ndryshuara, nenet e tjera mbeten në fuqi, gjithashtu edhe procedurat e ndjekura do të jenë po njësoj. Hartimi i një ligji të ri do të ishte i justifikuar nëse ndryshimet do të preknin më shumë se 50% të ligjit aktual. Në rastin konkret nuk gjendemi në këto kushte pasi ndryshimet e nevojshme kërkojnë ndërhyrje minimale ligjore.

Opsioni 2: – Ndryshimi i ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, me anë të së cilit synohet të rritet vlera e gjobave për deklarimin e të dhënave të pavërteta nga subjektet tregtare dhe moskryerjen e regjistrimit fillestar brenda afateve të përcaktuara dhe regjistrime të tjera të detyrueshme të subjekteve tregtare

Ky është opsioni i zgjedhur dhe preferencial, pasi është një zgjidhje afatgjatë dhe arrijmë qëllimin tonë, i cili është vetëm rritje e vlerës së gjobave pa ndërhyrë në procedura të tjera apo duke kërkuar amendime të tjera të Ligjit. Amendimet e kërkuara mund të arrihen duke ndryshuar pikat 2 dhe 3 të nenit 74, pra nëpërmjet këtij opsioni. Ndryshimet e nevojshme kërkojnë ndërhyrje minimale ligjore.

Opsioni 3 (jorregullator) -Kryerja e fushatave sensibilizuese për zbatimin e rregullt të ligjit në fuqi; hartimi dhe publikimi i manualeve për rregullat procedurale që duhen ndjekur në kuadër të këtij ligji; rritja e kontrollit, nga strukturat përgjegjëse, mbi strukturat dhe/ose bizneset/individët që duhet të zbatojnë legjisllacionin në fuqi.

Në qoftë se zgjidhet opsioni 3, Kjo është një zgjidhje e limituar dhe jo afatgjatë. Gjithashtu është edhe Jo efektive, pasi fushatat sensibilizuese nuk mund të jenë pa limit dhe të ndodhin gjatë gjithë kohës, për shkak të kostos dhe kohës.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasimore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
 - *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
 - *Përmbliidhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Ky projektligj do të ketë ndikime ekonomike te buxheti i shtetit dhe te subjektet e regjistruara në regjistrin tregtar.

Te subjektet tregtare- Rritja e vlerës së gjobave do të rëndojë mbi buxhetin e bizneseve që kryejnë shkeljet për të cilat aplikohen gjobat.

Te qeveria implikimet buxhetore janë dy, në këtë rast;

1.Bizneset ndërjegjësohen nga vlera e lartë e gjobave dhe zbatojnë ligjin me përpikmëri, cka sjell uljen e numrit të gjobave dhe mosarkëtim të tyre në buxhetin e shtetit.

2.Bizneset kryejnë shkeljet e sipërpërmenduara, duke sjellë penalizimin e tyre me gjobat më të larta, cka sjell arkëtim dhe rritje të të ardhurave në buxhetin e shtetit.

Analiza me shumë kritere e opsioneve;

Opsionet që janë marrë në konsideratë për analizën me shumë kritere janë:

Opsioni 0: – status quo-ja, të vijohet me kuadrin ligjor ekzistues

Opsioni 1: – Shfuqizimi i ligjit aktual dhe hartimi i një ligji të ri

Opsioni 2:- Ndryshimi i ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, me anë të së cilit synohet të rritet vlera e gjobave për regjistrimin e të dhënave të pavërteta nga subjektet tregtare dhe moskryerjen e regjistrimit fillestar brenda afateve të percaktuara dhe regjistrime të tjera të detyrueshme të subjekteve tregtare

Opsioni 3 (jorregullator) -Kryerja e fushatave sensibilizuese për zbatimin e rregullt të ligjit në fuqi; hartimi dhe publikimi i manualeve për rregullat procedurale që duhen ndjekur në kuadër të këtij ligji;

Për të vlerësuar opsionet duke përdorur analizën me shumë kritere, janë ndjekur hapat e mëposhtëm:

Janë përcaktuar kriteret që tregojnë arritjen e objektivave:

1. Rritja e transparencës lidhur me deklarimin e të dhënave reale;
2. Rritja e ndërgjegjësimit për kryerjen e regjistrimit fillestar në afatin e caktuar
3. Rritje e vlerës së gjobës për mosplotësim të detyrimit ligjor për deklarimin e të dhënave të verteta dhe kryerjen e regjistrimit fillestar e regjistrimeve të tjera në kohën e duhur në kohën e duhur
4. Përmirësim i klimës së Biznesit duke rritur ndërgjegjësimin për përmbushjen e detyrimeve ligjore.
5. Kosto - efektiviteti

Është vendosur pesha e kriterëve sipas rëndësisë relative:

1. Rritja e transparencës lidhur me deklarimin e të dhënave reale -4
2. Rritja e ndërgjegjësimit për kryerjen e regjistrimit fillestar në afatin e caktuar- 4
3. Rritje e vlerës së gjobës për mosplotësim të detyrimit ligjor për deklarimin e të dhënave të verteta dhe kryerjen e regjistrimit fillestar e regjistrimeve të tjera në kohën e duhur në kohën e duhur -2
4. Përmirësim i klimës së Biznesit duke rritur ndërgjegjësimin për përmbushjen e detyrimeve ligjore- 3
5. Kostot - efektiviteti - 3

Pra, për të bërë dallimin e opsioneve nga njëra-tjetra dhe me qëllim përzgjedhjen e opsionit më të mirë secili kriter është vlerësuar me një peshë specifike vlerësuar nga 1-4;

Gjithashtu, secili kriter në varësi të peshës së tij, është vlerësuar me pikë përkatëse sipas shkallës së preferencës për çdo opsion për secilin kriter nga 0-5 ku 0 përfaqëson opsionin më pak të preferuar dhe 5 atë më të preferuarin.

Kriteret	Pesha	Opsioni 0	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Rritja e transparencës lidhur me deklarin e të dhenave reale	4	0 (0)	5 (15)	5 (15)	2 (8)
Rritja e ndërgjegjësimit për kryerjen e regjistrimit fillestar në afatin e caktuar	4	0 (0)	5 (20)	5 (20)	3 (12)
Rritje e vlerës së gjobës për mosplotësim të detyrimit ligjor per deklarimin e te dhenave te verteta dhe kryerjen e regjistrimit fillestar e regjistrimeve te tjera në kohën e duhurne kohen e duhur	2	0 (0)	5(10)	5 (10)	0 (0)
Përmirësim i klimës së Biznesit duke rritur ndërgjegjesimin per permbushjen e detyrimeve ligjore.	3	0 (0)	5(15)	5(15)	3 (9)
Kosto-efektiviteti	3	1 (3)	3 (9)	5 (15)	2 (6)
Pikët		3	69	75	35

Pra sic e shikojmë edhe nga Matrica e performancës së opsioneve, opsioni 2 ka më shumë pikë se opsionet e tjera cka vërteton përsëri se opsioni 2 duhet të jetë opsioni preferencial.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Pas vlerësimit të kujdesshëm të opsioneve lidhur me hapat ligjor që duhet të ndiqeshin për permbushjen e rekomandimeve të ICRG/FATF, është përzgjedhur Opsioni 2: – ndryshimi i ligjit ekzistues, pasi kundravajtjet administrative vlera e të cilave kërkohen të rriten janë tashmë të parashikuara në ligjin aktual. Për këtë arsye, Opsioni 2: – ndryshimi i ligjit ekzistues mundëson:

- a. rritjen e vlerës së gjobës në rast:
 - i. deklarimit në regjistër i të dhënave të pavërteta, kur nuk përbën veprë penale,
 - ii. Moskryerjës së detyrimit për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të detyrueshme, brenda afateve të parashikuara nga ligji nr. 9723/2007.
- b. permbushjen e rekomandimeve të ICRG/FATF

Referuar të dhënave gjoba e aplikuar në shtetin e Malit të Zi (1000 Euro), referuar indeksit të mësipërm këtu në Shqipëri do konvertohej në një vlerë rreth 670 Euro.

Nëse një përlllogaritje të tillë do ta bënim referuar vlerës maksimale të gjobës që aplikon shteti Slloven (400 Euro) do na rezultonte që këtu në Shqipëri kjo gjobë do të konvertohej në një vlerë rreth 140 Euro.

Nëse përsëri të njëjtën përlllogaritje të tillë do ta bënim referuar vlerës minimale të gjobës që aplikon shteti Grek (600 Euro) do të rezultonte që këtu në Shqipëri kjo gjobë do të konvertohej në një vlerë rreth 290 Euro.

Sikundër shihet përlllogaritjet e mësipërme japin vlera të ndryshme.

Nëse do të bënim një mesatare të këtyre vlerave të cilat aplikohen në rajon do të rezultonte një vlerë rreth 370 Euro.

Për këtë arsye mendojmë se vlera më e përshtatshme e propozuar për këtë gjobë të variojë midis shifrave 30000 lekë deri në 45000 lekë, gjë e cila përafrohet me dyfishimin ose trefishimin e vlerës së gjobës aktuale.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Masa kryesore është rritja e vlerës së gjobës në rast:

- deklarimit në regjistër i të dhënave të pavërteta, kur nuk përbën vepër penale,
- Moskryerjes së detyrimit për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të detyrueshme, brenda afateve të parashikuara nga ligji nr. 9723/2007.

Gjatë zbatimit të Ligjit mund të hasen pengesa të shumta lidhur me kundërshtimin e subjekteve tregtare për këtë amendim, pasi është kosto që rëndon direkt buxhetin e tyre të të ardhurave. Një pengesë/kundërshtim tjetër mund të vijë nga Shoqatat e Biznesit, që mbrojnë interesat e bizneseve që përfaqësojnë.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Ligji do të zbatohet drejtpërdrejt nga subjektet tregtare që regjistrohen në regjistrin tregtar dhe Qendra Kombëtare e Biznesit si institucioni implementues i Këtij ligji dhe zbatimit të tij. Ministria përgjegjëse për financat dhe ekonominë do të monitorojë zbatimin e opsionit të preferuar duke analizuar Raportet e përcjella në mënyrë periodike nga institucioni implementues (QKB)

Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në tota	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
--	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kostoja	Përfitimi	
Opsioni 1	N/A	N/A	N/A
Opsioni 2	N/A	N/A	N/A

MINISTËR

DELINA IBRAHIMAJ